



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 5 prot.

Kamëz, më 26.1.2026

V E N D I M
Nr. 5 ,Datë 26/1 2026
MBI

“MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI STREHIMIT SOCIAL “SUBVENCIONIMI I INTERESAVE TË KREDISË”, PËR VITIN 2026”.

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 26.1.2026, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr.04 Datë 20.1.2026 në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; të ligjit nr. 22/2018, “Për Strehimin Social” të ndryshuar; Vendimit nr. 384, datë 12.06.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”; Vendimit nr. 453, datë 3.7.2019, të Këshillit të Ministrave “Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti”, VKB nr.155 datë 20.11.2024 “Për miratimin e procedurave lidhur me programin social Subvencioni Interesave të Kredisë”; Relacionit Komisionit Strehimit me nr.511 Prot datë 15.01.2026, Procesverbalit Komisionit Strehimit me nr. Prot nr.511/1 Prot datë 15.01.2026, **Këshilli Bashkiak Kamëz**;

V E N D O S I:

1. Miratimin e listës së 42 familjeve për të përfituar nga programi Strehimit Social “Subvencionimi i interesave të kredisë”, për vitin 2026, sipas Aneksit nr. 1, dhe relacionit shpjegues bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Familjet e përcaktuara në Aneksin nr. 1 të këtij vendimi, duhet të paraqiten brenda gjashtë muajve pranë institucionit bankar, nga momenti i njoftimit që kryen Bashkia Kamëz.

Mosrespektimi i këtij afati është shkak për skualifikimin e tyre.

3. Të ngarkohen Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Strehimit, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për zbatimin e këtij vendimi.
Bashkëlidhur këtij vendimi gjendet lista e familjeve përfituese.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimit të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar.

KRYETAR KËSHILLI
HYSEN KOLDASHI